



Prishtinë, 05.10.2017

Të nderuar përfaqësues të Organizatës Child and Youth Finance International,

Të nderuar përfaqësues të Institucioneve financiare nga të gjitha shtetet

pjesëmarrëse në ngjarjen e sotme

Përfaqësues të të gjitha institucioneve të Kosovës,

Jam e nderuar që jam në mesin tuaj dhe ju mirëpres sot në Prishtinë për të diskutuar dhe ndarë përvojat për temën e edukimit financiar, e cila është e rëndësishme së veçantë për të gjithë ne sot dhe njëkohësisht që në praninë tuaj lansojmë, Programin e Edukimit Financiar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Një ndër qëllimet strategjike të BQK-së, është nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i funksionit të edukimit financiar, me qëllim të krijimit të kulturës së mirëfilltë financiare, që u ndihmon të gjitha palëve të interesit për të marrë vendime të duhura mbi bazën e njohurive të mjaftueshme. Këto njohuri mund të përfitohen vetëm me një edukim adekuat financiar që rrjedhimisht njohuritë e përfituara financiare transformohen në sjellje financiare. Ky do të ishte realiteti optimal që të gjithë ne sot të pranishëm e aspirojmë,....por sa kemi arritur ta realizojmë këtë realitet.

Për disa momente do të kisha dashur që vëmendjen ta sjelli në tri dimensionet kryesore në funksionin e së cilave ka qenë edukimi financiar, dhe atë në funksion të stabilitetit financiar, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe në funksion të gjithëpërfshirjes financiare. Këto tri dimensione në fakt përshkojnë tërë procesin e aktivitetit financiar, nga ballafaqimi i parë me produkt/shërbim financiar e deri te realizimi i së drejtës/obligimit në rast të dështimit të institucionit financiar. Këto tri dimensione demonstrojnë rolin kritik që ka edukimi financiar sepse gjithçka fillon dhe përfundon me edukimin financiar.

Edukimi financiar në funksion të stabilitetit financiar; Sikurse për shumicën e bankave qendrore të botës, edhe BQK-ja, objektiv primar ka ruajtjen e stabilitetit financiar. Sa më shumë agjentë ekonomikë të edukuar financiarisht aq më shumë stabilitet financiar do të kemi në vend. Edukimi financiar është thelbi i ndërtimit të besimit. Pa besim nuk mund të ketë stabilitet financiar. Nëse e shikojmë nga perspektiva e mirëqenies sociale, ka shumë rëndësi se a janë njerëzit në gjendje të menaxhojnë në mënyrë të duhur mjetet e tyre financiare. Mirëpo në anën tjetër përfitimet e njohurive financiare shtrihen përtej bilanceve dhe të ardhurave familjare, deri te promovimi i një sistemi financiar stabil dhe alokim efikas të burimeve brenda ekonomisë reale.

Edukimi financiar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve; Mbrojtja e konsumatorëve dhe edukimi financiar janë proces i integruar aktiv, në të cilin komunikimi i informatave është vetëm fillimi, përderisa qëllimi final është sjellja pozitive financiare afatgjatë. Vendimet e konsumatorëve për shfrytëzim të produkteve dhe shërbimeve merren mbi bazën e informacionit të plotë dhe të drejtë, si dhe njohurive që kanë për të kuptuar këto informacione, prandaj edhe shpalosja e tyre nga institucionet financiare është shumë kritike. Për më tepër qasja e tillë shpie drejt një konkurrence të drejtë të të gjithë akterëve të sektorit financiar.

Gjithëpërfshirja financiare: Shërbimet dhe produktet e sektorit financiar prekin jetën e secilit qytetar të Kosovës. Prandaj, ndërtimi i një tregu financiar që trajton konsumatorët në mënyrë të drejtë inkurajon përfshirjen financiare dhe ndihmon qytetarët në përdorimin efektiv të shërbimeve financiare, si premisë kryesore e gjithëpërfshirës financiare. Njëkohësisht, është po aq e rëndësishme që qytetarët vazhdimisht të kërkojnë informata për të krahasuar kushtet dhe afatet e produkteve financiare - dhe më e rëndësishme është që ata të ngrenë zërin e tyre në qoftë se ndeshën me probleme.

Të gjithë sot këtu pajtohem se përmes edukimit financiar kemi arritur të adresojmë shumë sfida në kuadër të të tria këtyre dimensioneve, por që ka ende punë për t'u bërë dhe paralelisht me vazhdimin e agjendës në këto tri dimensione, ne duhet të jemi të vëmendshëm për një dimension të ri me sfidat e të cilit duhet të ballafaqohemi në kohë dhe përshtatshëm – **dimensioni i zhvillimit të përshpejtuar teknologjik në veçanti bota virtuale e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve financiare.**

Sistemi financiar është duke evoluar në vazhdimësi drejt zgjerimit të produkteve dhe shërbimeve financiare më komplekse, prandaj programi i edukimit financiar duhet t'i përgjigjë me proaktivitet këtij dimension të ri. Kjo na sjell në një kapitull të ri në fushën e edukimit financiar, të cilin lirshëm mund ta quajmë **edukimi financiar 2.0**. Edukimi financiar 2.0 përfshinë në vete përpjekje të gjerë, efektive dhe afatgjatë në kulturën financiare dhe edukimin financiar. Gjithnjë duke u bazuar në qëndrueshmëri, qasje sistematike, inovative, gjithëpërfshirëse dhe metodat e avancuara teknologjike. Mbi të gjitha për të realizuar këtë kritikë është të kemi qasje të integruar të të gjithë akterëve relevantë dhe rregullim institucional në atë format ku kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve janë në funksion të të disenjmit të programeve të edukimit financiar.

Kjo mund të jetë e kushtueshme, por padyshim se përfitimet e dala nga ky proces nuk kane çmim. Prandaj, vlerësoj që takimi i sotëm do të sigurojë një forum për diskutimin e rrugës përpara në këtë drejtim.

Dhe krejt për fund, me lejoni që të ndaje me ju sot një të arritur të veçantë të cilën e kemi realizuar për përmbushur nevojat gjithnjë e më të mëdha të agjendës së edukimit financiar ku sot do shpalojmë Programin e Edukimit Financiar i cili është përkrahur dhe mbështetur nga EFSE, aktivitetet e të cilit do të realizohen dhe implementohen, në Qendrën e Vazhdimësisë së Biznesit në Prizren e cila është e destinuar edhe si Qendër për Trajnim dhe Edukim Financiar.

Në përmbyllje ju dëshiroj punë të mbarë, këmbim mendimesh e përvojash dhe sukses në prezantimet tuaja, gjatë ditës së sotme, dhe shpresoj takimi i sotëm jo vetëm të përmbush por edhe tejkaloj pritjet tuaja.

Ju faleminderit !